



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 766/4 prot.

Tiranë, më 10. 11. 2017

V E N D I M

Nr. 121, Datë 10. 11. 2017

Mbështetur në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 64, datë 03.08.2017, nga shtetasi N. O., ku pretendon diskriminim për shkak të “racës” nga ana e Bashkisë Fier.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

Sipas informacionit të dhënë, shtetasi N. O. pretendon se ka patur probleme me aktin e pronësisë për shkak të emrit të rregjistruar gabim në gjendjen civile. Ka kërkuar nga ana e Zyrës së Gjendjes Civile të Njësisë Administrative Levan për të korrigjuar emrin dhe prej një periudhe 2-mujore nuk ka marrë asnjë përgjigje. Në këto kushte ankuesi pretendon se fakti që i përket komunitetit rom/egjiptian, bën që të trajtohet në mënyrë të pabarabartë dhe diskriminuese nga e Bashkisë Fier.

Raca është një nga shkaqet për të cilat Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ofron mbrojtje. Në nenin 1 të tij përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32, pika 2 dhe 33, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Mbështetur në nenin 33, pika 5 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, me shkresën nr. 766/1 prot., datë 10.08.2017, është bërë njoftimi i Bashkisë Fier, nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi lidhur me nisjen e procedurave të shqyrtimit të ankesës, si dhe është kërkuar informacion mbi pretendimet e ngritura nga ankuesi.

Me shkresën¹ nr. 365 prot., datë 07.09.2017, Bashkia Fier, informoi Komisionerin lidhur me pretendimet e ngritura nga ankuesi, N. O., ku ndër të tjera sqaroi se: “...nga verifikimet e kryera në Rregjistrin themeltar të vitit 1974, Levan, nr. 34/52 dhe 48/21, rezulton se gjatë transkriptimit të të dhënave nga veçimi i familjes, më datë 29.02.1984, është transkriptuar emri gabim nga N. në N.. Ju informojmë gjithashtu se shtetasi N. O., i datëlindjes 11.06.1953, me atësi Bejtash, amësi Taibe, vendlindja Hekal-Fier, nuk ka paraqitur asnjë kërkesë për korrigjim emri në Zyrën e Gjendjes Civile Levan Fier.”

2. Përsa më lart, në vijim të procedurave hetimore, Komisioneri me anë të shkresës nr. 766/3 prot., datë 11.09.2017, i vuri në dispozicion ankuesit kopje të shkresës nr. 365 prot., datë 07.09.2017 të Zyrës së Gjendjes Civile të Njësisë Administrative Levan, Fier dhe i kërkoi sqarimet përkatëse mbi përgjigjen e sipërcituar.

Refruar Lajmërim-Marrjes së Postës Shqiptare me Nr: RR 108 416 452 AL, ankuesi ka marrë dijeni më datë 16.09.2017, mbi shkresën e sipërcituar dhe nuk ka dhënë asnjë në përgjigje apo informacion shtesë.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

Mbështetur në provat e administruara nga të dy palët, rezultoi se:

Lidhur me trajtimin ndryshe dhe të pafavorshëm

Mbështetur në informacionin e administruar, rezultoi se shtetasit N. O. nuk i është mohuar për asnjë moment, si dhe nuk ka dorëzuar asnjëherë kërkesë me shkrim pranë Zyrës së Gjendjes Civile të Njësisë Administrative Levan, Fier, për të bërë korrigjimin e emrit të tij në Rregjistrin Themeltar të këtij institucioni.

Në përfundim, pretendimet e shtetasit N. O. se raca është bërë shkak për trajtimin në mënyrë të pabarabartë dhe të padrejtë, nuk mbështetet në asnjë nga provat dhe faktet e administruara nga Komisioneri gjatë procedurave hetimore.

¹ Protokolluar pranë KMD-së me nr. 766/2 prot., datë 11.09.2017

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 3, 4, 7, pika 1, nenin 20, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a), si dhe nenin 33, pikat 1, 3, 5, 7 të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

- 1.** Konstatimin e mosdiskriminimit, për shkak të racës, së shtetasit N. O., nga ana e Zyrës së Gjendjes Civile të Njesisë Administrative Levan, Fier.
- 2.** Rekomandimin e subjektit ankues, të paraqitet pranë Zyrës së Gjendjes Civile të Njesisë Administrative Levan, Fier dhe nëpërmjet një kërkesë me shkrim të kërkojë ndryshimin apo korrigjimin e emrit të tij.
- 3.** Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda afateve ligjore.

KOMISIONERI

Irma BARAKU

(Shkaku: Raca)

(Fusha: Të mira dhe shërbime)